



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kosova Net
Burim Qehaja
Drejtor
Kamenicë

Ankesa Nr. 2014/196 KPM vs Kosova Net
Ref:1503/282/LEG/hzg

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2014/196 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Operatorit Kabllor Kosova Net (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse me datë 30 tetor 2013, është pajisur me licencë të KPM-së. Me marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me datën 22 gusht 2014 ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse në selinë e tij dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar 48 kanale për të cilat nuk ka deponuar dëshmi në KPM se ka të drejtën e ritransmetimit të tyre. Gjithashtu, KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk bartte as Kanalin Informues.
3. KPM duke u bazuar në monitorimin e bërë me datën 5 shtator 2014, përmes një kërkesë ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse, që në afat prej pesë (5) ditësh t'i sjellë marrëveshjet valide me të cilat dëshmon se ka të drejtën e bartjes së 48 kanaleve.
4. KPM, me datën 11 shtator 2014, ka pranuar një përgjigje në mënyrë elektronike nga Pala Përgjegjëse, përmes të cilës pretendon se ka bërë ndërprerjen e bartjes së të kanaleve dhe se ka nisur negocimin për marrjen e pëlqimit për bartjen e tyre.

Faqe 1 nga 4

5. KPM, me qëllim të verifikimit të njoftimit të Palës Përgjegjëse që kjo e fundit ka bërë ndërprerjen e bartjes së kanaleve pa të drejtë autoriale, me 13 shtator 2014, ka bërë edhe një monitorim të kanaleve të bartura nga ana e Palës Përgjegjëse dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon t'i bartë kanalet për të cilat nuk posedon marrëveshje valide dhe të mos bartë kanal informues, duke vazhduar të jetë në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
6. KPM, bazuar në shkeljen e Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 25 shtator 2014, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën KPM do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
7. KPM edhe pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, sërish me datë 28 tetor 2014, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse në selinë e tij, ku është gjetur se edhe përkundër Njoftimit për Shkelje Pala Përgjegjëse vazhdon të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës. Në bazë të raportit të monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
8. KPM në bazë të raportit të monitorimi të datës 28 tetor 2014, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bartë 44 kanale pa të drejtë autoriale: *Rtv 21 Plus, Rtv 21 Popullore, Rtv Junior, Klan Kosova, Alsat M, First Channel, Tv Aldi, Tv Presheva, Peace Tv, Fox, Fox Life, Fox Crime, Travel Channel, Motors Tv, Euroneës, True Christmas, True Movies 2, True Entertainment, True Drama, Flava, Bliss, Scuzz, Chart Shoë Dances, The Vault, Chatr Shoë Tv, Pro Sieben, Kabel Eins, Vox Austria, Rtl Austria, Rtl2 Austria, Super Rtl Austria, Sat 1, Hse24 Extra, Sat 1 Gold, Pro Sieben Max, EM TV, MCJ Mediasa, AS TV, Ordu Atlas TV, Turkien TV, Maxi TV, Gala TV, Yildiz TV, Konya TV, Sun TV dhe Uzay TV.*
9. KPM bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 10 nëntor 2014, Palës Përgjegjëse i ka dërguar Vërejtje për shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. KPM i ka tërhequr vërejtjen Palës Përgjegjëse se veprimi i mëtutjeshëm në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës do të rezultojë me masa sanksionuese në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së.
10. KPM, edhe pas Vërejtjes së dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse, ku me datë 25 nëntor 2014, ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Vërejtjes ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës.
11. KPM, me datën 15 dhjetor 2014, ndërmori edhe hapin e fundit ndaj Palës Përgjegjëse, duke i dërguar Urdhër për shkeljen të nenit 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Pala Përgjegjëse është urdhëruar që menjëherë të veprojë në pajtueshmëri me të Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën KPM në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së, do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.

Analiza Ligjore

12. Komisioni i Pavarur për Media bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës i cili përcakton se:

“I licencuari nuk do të ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtën autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkeljet e tilla rezultojnë me revokim të Licencës”.

Pala Përgjegjëse, ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.5, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës i cili përcakton se:

“Për çdo ndryshim apo modifikim të listës së programeve, skadimin e afatit të kontratës dhe shtimin e kanaleve të reja, KPM duhet të njoftohet 7 ditë para se të bëhen ndryshimet nga i Licencuari. Kopjet valide të marrëveshjeve për të gjitha programet e reja që konsiderohen pjesë përbërëse e listës së programeve për ritransmetim do t'i dërgohen KPM-së nga ana e operatorit kabllor.”

Pala Përgjegjëse, gjithashtu ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 3.2.1 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton:

“I licencuari që ofron shërbime kabllore duhet të ketë një kanal të veçantë përmes së cilit identifikohet dhe njëkohësisht ofron informacione për parapaguesit për çdo ndryshim të mundshëm rreth shërbimeve të programeve përmes kabllor.”

13. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenin 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë bartjen e kanaleve pa të drejtë autoriale dhe nuk ka bartur kanalin informues për identifikimin e kanaleve të bartura.
14. Komisioni i KPM-së, duke u bazuar në raportet e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshme për të ardhur në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, duke transmetuar kanale pa të drejtë autoriale.
15. Bazuar në raportet e monitorimit është gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, Vërejtjes dhe Urdhrit të dërguar nga KPM përmes të cilave i është bërë me dije se është në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Pala Përgjegjëse në mënyrë të vazhdueshme ka bërë bartjen e kanaleve pa të drejtë autoriale.
16. Komisioni i KPM-së ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me nenin 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenin 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të respektimit të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës,

prandaj përmes kësaj Komisionit si rrethana rënduese për Palën Përgjegjëse ka marrë shkeljet e vazhdueshme edhe pas kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri.

17. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni i KPM-së vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3, dhe 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që në mënyrë të vazhdueshme ka bërë bartjen e kanaleve pa të drejtë autoriale si dhe nuk ka bartur Kanalin Informues.

Vendimi


18. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
19. Komisioni, vendosi që në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë në shumën prej 5,000.00 (pesëmijë) euro për shkeljen e vazhdueshme të nenit 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

E drejta për Ankesë

20. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
21. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



28.04.2015

datë